

Thojini Lamtumirë Pështjellimit ... dhe Mirë se Vjen Gëzimit!

A jeni të pështjelluar? A po ndodh diçka që nuk po e kuptoni në jetën tuaj? A jeni duke vrarë mendjen përse jeta ka ecur sipas rrjedhës së saj? A jeni duke pyetur “Pse, o Zot, Pse?”. Kjo ishte pyetja që dikur torturonte autoren e librave frymëzues më të shitur, Joyce Meyer, derisa ajo kuptoi se pritja për përgjigje i vidhte paqen dhe i plaçkiste gëzimin. Tani, edhe ju mund t’i jepni fund pështjellimit ... dhe t’i sillni përsëri gëzim jetës suaj. Lejoni Joyce Meyer t’ju tregojë se si:

- T’i jepini fund arsyetimeve robëruese
- Të mësoni të mbështeteni te Perëndia i plotë-besueshëm
- Të mos shqetësoheni më për të djeshmen apo të nesërmen
- Të çlironi mendjen nga kurthet e mishit dhe ta mësoni si të mendojë në mënyrë frymërore

Nëse jeni duke bërë pyetjen “Kur, o Zot, Kur?”, atëherë po bëni pyetjen e gabuar. Ky libër i mrekullueshëm do t’ju ndihmojë të gjeni rrugën për te Perëndia ... dhe ta shijoni jetën si kurrë më parë!



JOYCE MEYER

SI TË ÇLIROHEMI NGA PËSHTJELLIMI

Pse,
o Zot,
Pse?

P_{SE}, O Z_{OT}, P_{SE}?

PSE, O ZOT, PSE?

*Si të Çlirohemi
Nga Pështjellimi*

JOYCE
MEYER



JOYCE MEYER
MINISTRIES

Pse, o Zot, Pse?
Joyce Meyer

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta autorit © 2002 nga Albanian Bible Society. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje.

Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

Botim i Joyce Meyer Ministries
© 2011 nga Joyce Meyer
P.O.Box 655
Fenton, Missouri 63026

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç rasteve të lejuara në ligjin mbi të drejtat e autorit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet, apo të transmetohet në asnjë formë apo mjet, apo të ruhet në një bazë të dhënash ose sistem rikthimi kompjuterik, pa pasur më parë miratimin e shkruar të publikuesit.

Përktheu: Florant Metko
Redaktoi: Iva Çipuri

Shtypur nga SIENA

Emri dhe logoja e Joyce Meyer Ministries janë shenja dalluese me të drejta ekskluzive të kësaj shërbese.

PËRMBAJTJA



Hyrje	7
1. Çfarë e shkakton pështjellimin?	9
2. Çliruar nga “Arsyetimet”	13
3. Qëndrimi i besimit	17
4. Hiri vjen ditë pas dite	21
5. Ah sikur!	25
6. Po sikur?	29
7. Mos u udhëhiqni nga koka juaj	35
8. “Arsyetimet” shkaktojnë mashtrim	41
9. Pështjellimi vjedh gëzimin tuaj	47

HYRJE



Te Gjoni 10:10 thuhet se hajduti vjen për të vjedhur, vrarë dhe shkatërruar, por Jezusi erdhi që ti të mund ta kesh jetën dhe ta *shijosh* atë.

Satani kërkon t'ju grabisë ju gëzimin tuaj dhe rrjedhimisht t'ju pengojë për të shijuar jetën. Por unë lutem që ky libër do t'ju ndihmojë të mësoni se si “ta lejoni Perëndinë të jetë Perëndia” në jetën tuaj, me qëllim që ju të mund të shijoni bollëkun e paqes dhe gëzimit sepse Jezusi dha jetën e Tij që ju të mund t'i keni.

1



ÇFARË E SHKAKTON PËSHTJELLIMIN?

A jeni të çoroditur? A mos po ndodh diçka në jetën tuaj pikërisht tani, të cilën ju nuk po e kuptoni? Ndoshta është e kaluara juaj dhe ju thjesht nuk e kuptoni se përse jeta juaj duhet të kishte qenë ashtu siç qe. Ndoshta po pyesni: “Përse mua, Perëndi? Përse gjërat të mos ishin në këtë mënyrë apo në atë mënyrë? Përse gjërat shkuan ashtu siç shkuan? Unë thjesht nuk po e kuptoj!”

Fillova të kuptoja se një numër i madh njerëzish vuajnë jashtëzakonisht shumë nga pështjellimi. E kisha përjetuar këtë në të kaluarën dhe e dija se si pështjellimi mundonte njerëzit dhe fillova të mendoj thellë se përse njerëzit çoroditeshin dhe çfarë mund të bënin për ta ndaluar këtë gjë.

Një natë po mbaja një takim në Kansas City dhe në këtë takim ishin të pranishëm afërsisht 300 persona. Ndjeva se duhej t'i pyesja se sa prej tyre ndiheshin aktualisht të pështjelluar për çështje të caktuara në jetën e tyre. Për habinë time, pashë që vetëm dy persona nuk ngritën dorën lart dhe njëri prej tyre ishte bashkëshorti im.

Nëse e kam vënë re qartë, kjo do të thotë se 298 nga 300 persona ishin të pështjelluar. Që do të thotë 99.3 për qind. Ndërsa fillova ta provoja këtë duke pyetur grupe të ndryshme, pashë që kjo ishte situata pothuajse kudo. Sigurisht që përqindja ndryshonte, por ajo ishte gjithmonë e lartë.

Ndërsa mendoja thellë dhe i kërkoja Zotit të më tregonte se çfarë e shkakton pështjellimin, Ai më tha: *"U thuaj atyre që të ndalojnë së kuptuari çdo gjë dhe kështu kanë për të pushuar së qeni të pështjelluar."* Tani e kuptoj se kjo është saktësisht përse unë nuk po vuaj më nga pështjellimi. Ende kam shumë gjëra në jetën time të cilat nuk i kuptoj, por ama, tani ka një ndryshim të madh. Perëndia më ka çliruar nga përpjekjet për të kuptuar gjithçka. *Perëndia më ka çliruar nga arsyetimet ("mendimet" për të cilat flitet te 2 Korintasve 10:5), kështu që nuk përpiqem më që të kuptoj gjërat në jetën time të cilat*

nuk arrij t'i kuptoj dot.

Kjo duket pothuajse e lehtë, apo jo? Por ekziston liri e plotë nga mundimi i pështjellimit thjesht duke refuzuar tundimin për të kuptuar (arsyetuar)gjërat. Nëse vërtet ndaloni për një çast dhe mendoni për këtë, atëherë kjo ka kuptim, pasi e gjithë kjo ndodh në atë vend të quajtur "mendje".

Mendja është fushë-beteja ku lufta jonë me Satanin ose fitohet, ose humbet. *"Perëndia nuk është Perëndi trazimi"* (1 Kor. 14:33), por i tillë është Satani. Djalli na ofron teori dhe mendime të cilat nuk janë në një linjë me Fjalën e Perëndisë. Letra e Dytë e Korintasve 10:4-5, përmend një nga llojet e të menduarit që ne do të na duhet ta eliminojmë me qëllim që të fitojmë betejën dhe ky është arsyetimi. Vargjet vazhdojnë:

"Sepse armët e luftës sonë nuk janë mishërore, por të fuqishme në Perëndinë për të shkatërruar fortesat, që të shkatërrojmë mendimet dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë dhe të bëjmë rob çdo mendim që t'i bindet Krishtit (Mesias, të Vajosurit)."

2 Korintasve 10:4-5

Nëse Fjala na udhëzon që të mos përpiqemi që të kuptojmë gjërat, atëherë duhet të bindemi. Dhe kur

arsyetimet na vijnë, duhet që mendimet tona t'i sjellim nën bindjen e Jezusit. Këto vargje na thonë se ne jemi në një luftë dhe lufta jonë, beteja jonë, është kryesisht një betejë mendore. Satani sulmon mendjet tona.

Sipas këtyre vargjeve ne po merremi me sulmet e tij, me *imagjinatat*. A keni imagjinuar ndonjëherë gjëra të cilat nuk kanë qenë të vërteta ose a keni parë gjëra në ekranin e mendjes suaj që ju e dinit se nuk ishin të hijshme? *Teoritë* janë skema ose ide të ndryshme mbi mënyrën se si të zgjidhni problemet tuaja dhe *mendimet* veprojnë në përpjekje për të gjetur përgjigje ndaj pyetjeve që vetëm Perëndia duket se i ka.

Për të përmbledhur këtë kapitull, le të themi se pështjellimi shkaktohet nga përpjekja për të kuptuar ose gjetur një përgjigje ndaj një situatë që vetëm Perëndia duket se e di. Për një arsye apo një tjetër, atë e di vetëm Ai dhe Ai e di pse nuk po e tregon.

2



ÇLIRUAR NGA “ARSYETIMET”

Së pari, duhet të kuptoni llojin e mendjes që kisha unë, para se të çmoni vërtet çlirimin tim nga arsyetimi.

Herët në jetën time, unë arrita në përfundimin se të mos mbështetesh tek asnjë njeri, të isha e pavarur dhe të kujdesesha për veten, ishte politika më e mirë dhe më e sigurt. Kisha kuptuar se sa më pak ndihmë të kërkoja, aq më mirë do të isha, sepse në këtë mënyrë nuk do t'i kisha borxh askujt për asgjë. Isha lodhur nga lëndimi dhe mendoja se kjo lloj qasjeje do të më mbronte nga dhimbja.

Sigurisht që e kisha gabim, por m'u desh një kohë e gjatë që ta kuptoja dhe ta pranoja. Duke qenë se më kushtoi një kohë të gjatë, ato vite i kaloja duke u shqetësuar, arsyetuar, hamendësuar, teorizuar, imagjinuar, vuaja përbrenda, isha e zhgënjyer, e mërzhitur dhe kështu me

radhë, lista vazhdon. Sa më të pavarur jemi, aq më e vështirë bëhet për t'i besuar Perëndisë ose dikujt tjetër.

Zoti dëshiron që ne të jemi të varur nga Ai dhe jo të pavarur prej Tij dhe të varur nga vetja jonë. Sa më i varur të jesh në Krishtin Jezus, aq më shumë do të jesh në gjendje që t'ia lësh Atij gjërat që nuk i kupton, duke ditur që Ai e di dhe kur të jetë koha e duhur, Ai ka për të t'i zbuluar.

Mos e ngatërmoni këtë lloj qëndrimi me pasivitetin. Ne nuk duhet të jemi pasivë, të paktën jo kur bëhet fjalë për besimin. Nëse ju ndodh diçka juve apo një mikut tuaj dhe nuk e kuptoni fare atë që ndodhi ose përse ndodhi, atëherë sigurisht që duhet të filloni me lutje. Kërkojini Frymës së Shenjtë që t'ju japë të kuptoni, t'ju mësojë, të hedhë dritë dhe t'ju zbulojë dhe pastaj prisni derisa Ai të veprojë duke ditur se në kohën e Tij, Ai ka për të sjellë aftësinë për të kuptuar¹.

Kur pyetjet të ngrihen në zemrën tuaj, mund t'i peshoni ato për pak kohë, por në një moment të caktuar, kur filloni të ndiheni të pështjelluar, falenderoni Perëndinë që Ai ka përgjigjen, tregojini Atij se jeni të

¹ Joyce ka një libër në qarkullim mbi kohën e Perëndisë, të titulluar *Kur, o Zot, Kur?*

kënaqur që dini se Ai e ka përgjigjen dhe tregojini Atij se ju i besoni Atij se do t'jua tregojë kur të jetë koha e duhur.

Nuk keni për t'u çliruar nga arsyetimet dhe pështjellimi derisa të marrëni, ta bëni tuajën, këtë qëndrim që kam përshkruar. Ky qëndrim, meqë ra fjala, është *qëndrimi i besimit*.

3



QËNDRIMI I BESIMIT

Besimit mund t'i referohemi si një doktrinë ose si një rrugë nëpërmjet së cilës marrim nga Perëndia. Tek Efesianëve 2:8-9, shikojmë se është me anë të hirit *nëpërmjet besimit* që ne jemi të shpëtuar. Te Hebrejve 11:1 thuhet: "Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen". Ne mund ta përshkruajmë ose përkufizojmë besimin në mënyra të ndryshme, por besoj se një mënyrë shumë e thjeshtë për ta parë besimin, madje edhe për të dalluar nëse po veprojmë në besim ose jo, është të thuash se "besimi ka një qëndrim."

Qëndrimi i besimit na sjell në prehje. Te Hebrejve 4:3 thuhet se ata që kanë besuar te Perëndia hyjnë në prehjen e Tij. Gjithashtu te Hebrejve 4, thuhet se ai që ka hyrë në prehjen e Perëndisë (mos harroni se besimi

është porta hyrëse për në prehje) gjithashtu nuk ka më lodhje dhe dhimbje për të nga puna njerëzore. (Vargu 10.) *Të menduarit është punë dhe të çon në pështjellim, jo çlodhje.*

Qëndrimi i besimit thotë se unë do t'ia lë në dorë Atij përkujdesjen time, pasi Ai kujdeset për mua (1 Pjetri 5:7). Aty thuhet: *"Unë nuk kam përse ta di dhe kuptoj çdo gjë që ndodh. Unë jam i kënaqur të njoh Atë, të Vetmin që i di gjërat!* (Perifrazimi i autores). Më mirë kalo kohë duke njohur Atë, sesa të përpiqesh të kuptosh se çfarë po bën Ai.

Qëndrimi i besimit nuk sjell merak, shqetësim apo ankth për të nesërmen, sepse besimi kupton se, çfarëdo që të nevojitet për të ecur përpara, edhe në të panjohurat e së nesërmes, Jezusi tashmë ka qenë aty. Mos harroni, Ai është Ai që ishte, që është dhe që do të jetë. Ai ishte atje para se të hidheshin themelet e botës. Ai mori pjesë në krijimin. Ai ju njihte para se të lindnit. Ai ju formoi me duart e Tij në barkun e nënës. Ai jo vetëm që ishte aty në fillim, por Ai është Fillimi, Alfa.

Po çfarë mund të themi për përfundimin? A mos vallë Ai i nis gjërat dhe pastaj i lë në mes? *Jo!* Ai do të përfundojë atë që ka nisur. (Heb. 12:2; Fil. 1:6). Ai do të jetë aty në fund. Ai është Mbarimi, Omega. Më pëlqen

që këtë ta them kështu: “Ai jo vetëm që është Alfa dhe Omega, Fillimi dhe Fundi, por Ai është gjithashtu çdo gjë në mes të këtyre skajeve.”

Nëse do të presupozojmë se Jezusi do të vonohet edhe ca, mua më mbeten shumë të nesërme. Po kështu edhe ty. Jam e kënaqur të di dhe të qetësohem duke ditur se çfarëdo që të mbajë e nesërmja për mua, Ai mban të nesërmen dhe mua në pëllëmbën e dorës së Tij (Isaia 49:16).

Qëndrimi i besimit jeton ditë pas dite.

4



HIRI VJEN DITË PAS DITE

“Arsyetimet” ose na kapin në kurthin e së shkuarës, ose përpiqen të na shtyjnë drejt së ardhmes. Mos harroni, në Bibël thuhet: “Dhe besimi është” (Heb. 11:1). Nëse përpiqeni të jetoni në të shkuarën, atëherë jeta do të jetë e vështirë. Ai nuk e quajti Vetën “I madhi Unë isha.” Nëse përpiqeni të jetoni në të ardhmen ose përpiqeni të mësoni se çfarë do të ndodhë nesër, atëherë jeta ka për të qenë e vështirë. Ai nuk e quajti Vetën “I madhi Unë do të jem”. Por nëse e jetoni çdo ditë, këtë ditë, ditën në të cilën jeni tani, atëherë jeta ka për të qenë shumë herë më e lehtë. Ai tha: “Unë jam.” (Eksodi 3:14). Besimi është *tani*.

Ai u tha dishepujve gjatë stuhisë: “Përse kini frikë? Merrni zemër. Jam Unë!” (Mateu 14:27, perifrazim i autores). E kuptoni? Jezusi po u thoshte “Unë jam” këtu

për ju pikërisht tani dhe kur “Unë jam”, çdo gjë do të jetë në rregull. Jetojeni të sotmen! Shqetësimi për të djeshmen ose të nesërmen vjedh të sotmen. Juve ju është dhënë hiri për të sotmen. Hiri për të nesërmen nuk ka për të ardhur deri nesër dhe derisa hiri i së djeshmes të jetë përdorur i gjithi. Hiri është një lehtësues, favori dhe fuqia e Frymës së Shenjtë për t’ju ndihmuar të bëni çfarëdolloj gjëje që duhet të bëhet. Por ne nuk mund ta marrim atë më parë në kohë dhe ta ruajmë diku.

Kujtoni izraelitët në shkretëtirë! Perëndia i ushqeui ata në mënyrë të mbinatyrshme çdo ditë duke ua dërguar ushqimin nga qielli. Ata e quajtën “mana”. Ashtu si ne, ata dëshironin të siguroheshin se do të kishin mjaftueshëm për të nesërmen, ashtu si edhe për të sotmen. Ata donin të mendonin edhe për të nesërmen, në rast se Perëndia do të harronte të bënte mrekulli mëngjesin e së nesërmes, por Perëndia nuk i lejoi të mblidhnin më shumë sesa do t’u nevojitej për një ditë, përveç ditës së Sabatit. Dhe nëse do të mblidhnin më shumë nga sa u nevojitej për të jetuar në një ditë, atëherë teprica do të prishej.

Ndaluni dhe mendoni pak për këtë! Ky është një shembull i fuqishëm të cilin mund ta zbatojmë në jetët tona sot. Kur mendoni, shqetësoheni dhe merakoseni,

mos vallë po lini mënjatë mana për të nesërmen? Ati yt në qiell dëshiron që t'i besoni Atij për të nesërmen. Te Fjalët e Urta 3:5 thuhet që t'i besojmë Zotit me gjithë zemrën dhe mendjen (mendimet tona) dhe të mos mbështetemi në mençurinë tonë.

Dikur kam lexuar këtë ilustrim: Dy burra ishin burgosur për shkak të dëshmisë së tyre për Jezu Krishtin. Ata do të digjeshin në turrën e druve të nesërmen. Njëri prej tyre ishte një shenjtor i moshuar, i cili kishte përvojë të madhe në rrugët e Perëndisë. Tjetri ishte një i ri, i cili e donte Zotin shumë, por që nuk kishte shumë përvojë në rrugët e Perëndisë.

Djaloshi mori shkrepësen për të ndezur një qiri, pasi nata po binte dhe dhoma po errësohej. Gjatë këtij procesi, dogji gishtin. Filloi të mërzhitej shumë dhe po bërtiste me të madhe nga frika, duke thënë: "Nëse diegia e gishtit po më dhemb kaq shumë, atëherë nuk kam për të qëndruar dot në turrën e druve". Shenjtori i moshuar e qetësoi djaloshin me këto fjalë: "Bir, Perëndia nuk të kërkoi të digjje gishtin, prandaj nuk të dha hir. Ai po të kërkon ta bësh këtë sakrificë të jetës tënde dhe ti mund të jesh i sigurt që kur të vijë mëngjesi, hiri ka për të qenë aty për të bërë atë që duhet të bësh."

I moshuari, shenjtë më me përvojë, e dinte nga vitet që kishte ecur me Zotin se, kur mëngjesi të vinte, hiri i Perëndisë do të ishte aty, pa asnjë dyshim. Kështu, ai u ngushëllua në të *tanishmen*, sepse kishte besim *tani* se nesër aftësia (*hiri*) do të ishte aty.

Nga ky shembull mund të kuptoni se besimi na çliron nga “arsyetimet”. Besimit nuk i duhet të kuptojë të ardhmen. Besimi prehet sepse e di që Perëndia do të sjellë manën e së nesërme nesër. Unë vërtet ju inkurajoj të mos e harxhoni kot të sotmen për të kuptuar (*menduar*) se çfarë ndodhi në të kaluarën apo se çfarë do të ndodhë në të ardhmen.

Ashtu siç kam lexuar dikur: “E djeshmja është si një çek i anuluar, e nesërmja është si një dokument për një shumë parash të premtuara dhe e sotmja janë të vetmet para që ke në dorë. *Përdori me mençuri!*”

5



AH SIKUR!

Apostulli Pal na mëson te Filipianët që të largojmë gjithçka që shtrihet në të kaluarën dhe të shikojmë atë që është para nesh. (Filipianëve 3:13). Si mund të kapemi te e kaluara nëse nuk kapemi pas mendimeve tona? Unë besoj se mund t'i kthejmë kurrizin të jetuarit në mentalitetin e së shkuarës dhe atë energji duhet ta shpenzojmë për të sotmen.

A i rijetoni ndonjëherë gabimet e së shkuarës herë pas here? A mendoni ndonjëherë: "Përse e bëra këtë? *Ah, sikur* të mos e kisha thënë apo bërë atë." Ose, "*Ah sikur* të kisha bërë kështu e kështu me radhë". Ki kujdes nga "*ah sikur-et*"!

Ndoshta mendoni se po bëni çdogjë sipas mënyrës që duhet bërë dhe përsëri gjërat prishen. Ju mund

të pyesni: “Përse gjërat shkuan ashtu siç shkuan? Pse, o Zot, Pse? Nuk e kuptoj. Unë duhet ta kuptoj këtë! Unë nuk mund të rri pa e ditur! Oh, jam shumë i ngatërruar!”

A ju duket se edhe ju mendoni kështu? A mund të jem shumë e drejtpërdrejtë? *Ju po torturoni veten tuaj!* Unë kam kaluar vite në këtë mënyrë. *Nuk ecën!* Në të kaluarën time kam pasur dhe kam shumë gjëra që nuk i kam kuptuar dhe vazhdoj të mos i kuptoj. Por falenderoj Perëndinë se më në fund Ai më përcolli mesazhin që të largoja atë që ishte mbrapa meje dhe të vazhdoja të shikoja atë që ishte tashmë përpara. Tani unë gëzoj një paqe jashtëzakonisht të madhe.

Fjala e Perëndisë thotë tek Isaia 26:3 se Perëndia do ta mbajë në paqe të përsosur mendjen që pushon tek Ai. Aty nuk thuhet mendja e atij që është i zënë me arsyetime apo që përpiqet të kuptojë gjithçka, do të mbahet në paqe të përsosur.

Ka shumë gjëra në dukje të padrejta, të pandershme, që ndodhin. Në të kaluarën time, ashtu siç mund të ketë ndoshta edhe te ju, kanë ndodhur shumë gjëra të cilat ishin jo të drejta, gjëra që më shkaktuan shumë probleme, plagë dhe dhimbje, për të cilat m’u deshën vite t’i rikuperoja.

Kalova vite të tëra në vetë-keqardhje me një gjemb në shpatull, e hidhëruar dhe e mërzhitur, në përpjekje për të arsyetuar se përse kjo më ndodhi mua. Përse Perëndia nuk më ndihmoi? Përse nuk më ndihmoi dikush?

Më në fund e kuptova se po bëhesha një mjerane. Po harxhoja kot të gjitha të sotmet në përpjekje për të kuptuar të djeshmet. Perëndia më tha një ditë: "Joyce, ti mund të jesh pikëllimplotë ose fuqiplotë. Cilën nga këto dëshiron?"²

Nganjëherë madje mund të jetoni në fitoret e së djeshmes. Mund të kapeni në përpjekjen për të arsyetuar se çfarë bëtë që ju solli suksesin, me qëllim që ta përsërisni sërish. Unë *zhjtesha* mendërisht në fitoret e mia në të kaluarën. Madje edhe kjo mund t'ju ndalojë së ecuri përpara. E kaluara është e kaluar. Nëse e kaluara ka pasur dështime ose fitore, ajo mbetet sërish e kaluar. Tashmë ka ikur. *Jetoni të sotmen!*

Nuk ka asgjë të gabuar me kujtimet e këndshme, por është gabim, dhe gabim i madh madje, të *jetoni* në fitoret e së shkuarës. Pas çdo ngjarjeje në jetën tuaj, lejoni

² Joyce ka një audio kasetë me mësimet, të titulluar: "Ktheje vetë-keqardhjen në fuqi".

perden që t'ju bjerë para këmbëve, ndërsa largoni atë gjë dhe vazhdoni me diçka tjetër që Perëndia ka për ju. Te Filipianëve 3:13 thuhet: "... duke harruar ato që kam lënë pas, dhe duke u zgjatur drejt atyre që kam përpara."

Dua t'jua përsëris prapë që të keni kujdes nga "*ah, sikur-et*". Nëse ka ndodhur një gjë e keqe, atëherë mund të mendojmë "*ah, sikur*" të mos e kisha bërë në atë mënyrë! Nëse ka ndodhur një gjë e mirë, atëherë mund ta gjejmë veten duke menduar "*ah, sikur*" ta bëja që të ndodhte sërish!

Harroni të kaluarën! Mos u përpiqni ta arsyetoni më! Merrni *tani* një vendim për të ecur përpara!

6



PO SIKUR?

Një tjetër shigjetë mendore, (Bibla i quan ato te Efesianëve 6:16 “shigjeta të zjarrita”), që Satani lëshon drejt jush është shprehja frikë-prodhuese, *po sikur!*

Po sikur paratë të mos vijnë më? *Po sikur* të lëndoheni? *Po sikur* të sëmureni rëndë? *Po sikur* t’ju pushojnë nga puna? *Po sikur* të mbeteni të vetmuar për gjithë jetën? Ose kjo tjetra, *po sikur* të mos jeni duke dëgjuar nga Perëndia? *Po sikur* të gaboni? *Po sikur* të dështoni? *Po sikur* ata t’ju qeshin? *Po sikur* të mos t’ju pranojnë? Dhe lista vazhdon e vazhdon. A e dalloni strukturën e mendimit?

Po sikur-et janë një formë tjetër e përpjekjes për të kuptuar gjithçka nëpërmjet “arsyetimit”. *Po sikur* vjen dhe zakonisht ndiqet nga një lumë i madh mendimesh që

paraqesin një tablo të zymtë. *Po sikur* na çon në të ardhmen dhe na bën t'i kemi frikë gjërat që ende akoma nuk kanë ndodhur dhe ndoshta nuk kanë për të ndodhur kurrë, nëse nuk i krijojmë vetë nëpërmjet frikës.

Po sikur shkakton pështjellim ashtu si *ah, sikur*. Të dyja këto janë forma të menduari të cilat ne nuk duhet t'i përkëdhelim. Sigurisht që ato janë të përfshira tek 2 Korintasve 10 nën titullin "teori dhe mendime ose imagjinata", të cilat duhet të nxirren jashtë të gjitha.

Më lejoni t'ju jap një shembull praktik të asaj që dua të them. Në një moment të caktuar, shërbesa jonë kishte nevojë për një godinë ku do të zhvillonim takimin tonë të përjavshëm. Godina ku mblidheshim për më shumë se pesë vjet do të shembej pas afërsisht dy vjetësh dhe aty do të ndërtohej një qendër tregtare. Po kërkonim një ambient në të cilin të vendoseshin zyrat tona dhe të mund të zhvillonim takimin e përjavshëm me hapësirë edhe për fëmijët, për shërbesën e fëmijëve dhe një dhomë ku të rriteshin etj. Gjithashtu na nevojitej edhe një hapësirë për 300 vende parkimi.

Tani, kushdo do të mendonte se kjo nuk duhet të ishte kaq e vështirë për t'u gjetur; megjithatë, nuk ishte aq e lehtë sa mendon. Kishim dy vjet që po kërkonim. Nuk kishim lënë asnjë mundësi për të cilën kishim dijeni.

Dukej sikur me të vërtetë kishim arritur në një rrugë pa krye.

Djalli na lëshonte shigjeta të zjarrita, si: “*Po sikur* të dy vitet të kalojnë dhe ju të mos keni akoma një vend?” Ose na dërgoi një shigjetë të zjarrtë që mbante mesazhin: “*Ah, sikur* të kishit marrë atë ose këtë vend kur ju dha mundësia me aq pak para, tani nuk do të ishit në këtë situatë që jeni. *Po sikur* të mos e kesh vënë re atë që Perëndia donte? *Sikur* të dije pak më shumë në lidhje me këtë gjë, atëherë ndoshta do të dije se çfarë të bëje. *Po sikur* të blini pronën dhe pastaj të mos ju japin lejet që ju nevojiten? *Po sikur* të paguani më shumë dhe pastaj të gjeni diçka më të mirë dhe me çmim më të leverdisshëm?”

Unë shpesh falenderoj Perëndinë që më kishte çliruar nga zgjedha e arsyetimit, para se çështja e godinës të ngrihej para nesh. Nëse e njëjta situatë do të kishte ndodhur disa vite më parë, atëherë me të vërtetë që do të isha e mjeruar, e pështjelluar dhe do isha plot frikë, në përpjekje për të kuptuar të gjitha këto gjëra.

Tani jam në gjendje të besoj se hapat tona janë drejtuar nga Perëndia. (Psa. 37:23). Ne po i lutemi dhe po i besojmë Perëndisë dhe duam vullnetin e Tij. Rrjedhimisht Ai do të na udhëheqë drejt vendit të duhur,

në kohën e duhur. Perëndia zakonisht nuk është herët, por Ai nuk është *kurrë* vonë. Kishim pazare të ndryshme që u përpoqëm e u përpoqëm shumë që t'i mbyllnim në të kaluarën, por që nuk ecnin, pavarësisht se sa shumë përpiqeshim. Megjithatë, në kohën e duhur, Perëndia siguroi për ne një vend të madh me qera dhe Ai do të vazhdojë të sigurojë në secilin hap të rrugës sonë.

Tani mund t'i shoh situatat e ndryshme dhe të kuptoj se përse nuk kanë qenë të duhurat. Por në atë kohë dukej sikur po përpiqesha kaq shumë që të gjeja një vend dhe asgjë nuk po na shkonte mirë. Asgjë nuk ka për të shkuar mirë kur jemi jashtë kohës së Perëndisë, në përpjekje *për të bërë* diçka që të ndodhë.

Perëndia e di vërtet se çfarë po bën. Ai është me të vërtetë në kontroll. Kështu që mund të qetësohem dhe të di se edhe nëse nuk e di se çfarë do të bëj, unë e njoh Atë që është në dijeni të gjithçkaje.

Po ju? A e njihni Jezusin? Atëherë edhe ju duhet ta njihni Perëndinë e gjithëdijshtëm, të gjithëpushtetshëm dhe të kudondodhshëm, Atë që është i plotfuqishëm, plot dije dhe kudo i pranishëm gjatë gjithë kohës.

Qetësohuni! *Po sikur* të mendoni e të mendoni dhe të kujtoni se më në fund i keni kuptuar të gjitha dhe Perëndia ju bën një surprizë dhe e bën në një mënyrë

tërësisht të ndryshme? Pastaj e gjithë koha do të ketë shkuar dëm. A nuk keni harxhuar kohë në arsyetime dhe pështjellime?

Po ju jap një ide: *Po sikur* thjesht të qetësoheni dhe ta lejoni Perëndinë të jetë Perëndia?

7



MOS U UDHËHIQNI NGA KOKA JUAJ

Po lutesha që aftësia për të kuptuar të funksiononte në një masë më të madhe në jetën time. Në fakt, isha lutur për këtë për shumë kohë, kur Fryma e Shenjtë më tha: “Nuk do të veprosh kurrë në mprehtësi Joyce, derisa ta lësh mënjatë arsyetimin.”

Te Letra e Parë e Korintasve 2:14-16, na thuhet qartë se njeriu natyror nuk e kupton njeriun frymëror. Zoti përdori këtë varg për të më bërë dallimin. Nëse fryma ime do të nxirrte në pah mprehtësinë dhe koka të arsyetonte nëse kjo do të kishte kuptim ose jo, atëherë unë nuk kisha për të ecur kurrë përpara. Përse? Për shkak të asaj që thuhet tek 1 Korintasve 2:14: Njeriu natyror nuk i kupton gjërat e frymës, sepse ato janë të

dallueshme frymërisht. Fryma jote di gjëra që koka jote nuk i di.

Nëse jeni një fëmijë i rilindur i Perëndisë, atëherë Fryma e Shenjtë banon në frymën tuaj njerëzore. Unë besoj se Fryma e Shenjtë përpiket të na tregojë shumë gjëra të cilat ne i kundërshtojmë, sepse veprojmë kaq shumë në fushën e frymërisë.

Po ju jap një shembull. Një mëngjes, ndërsa po vishesha për të shkuar në një prej takimeve tona të përjavshme, “Jeta në Botë”, fillova të mendoja për gruan që drejton shërbesën e ndihmesës në atë takim të caktuar dhe se sa besnike kishte qenë. Kështu në zemrën time lindi një dëshirë për të bërë diçka për të, për ta bekuar në ndonjë farë mënyre.

Thashë: “Zot, çfarë mund të bëj unë për Ruth Ann?” Aty ndjeva një ndjenjë të fortë, ose mund të thuash, *unë e dija* se do t’i jepja asaj një fustan të kuq që varej në dollapin tim. Atë fustan e kisha blerë para tre muajsh. Megjithëse e pëlqeja vërtet, sa herë që mendoja ta vishja, thjesht nuk kisha dëshirë ta vishja. Ende ishte i varur në qesen e plastmasit, siç e mora nga dyqani, me të gjitha etiketat. Ruth Ann ishte një grua pak më e bëshme se unë, por çuditërisht, unë e kisha blerë fustanin një numër më të madh nga sa i vesh zakonisht, sepse në dyqan

nuk kishte në masën e trupit tim. Nisur nga stili i fustanit, nuk mendoja se ndokush do ta vinte re se më rrinte pak i madh.

Tani, kur në frymën time më lindi kjo dëshirë e fortë për t'ia dhënë asaj fustanin, koka më tha: "Por, Zot, ky fustan është i ri!" Vini re se, ndërsa koka ime, njeriu natyror, debaton me frymën time, debati nuk ka më kuptim fare. Pastaj thashë: "Sigurisht që nuk po më thua të jap një fustan që është i ri fare." Në fakt, nëse do të kisha menduar në lidhje me karakterin e Perëndisë, bujarinë dhe përsosmërinë e Tij, atëherë do ta kisha ditur se Perëndia ka më shumë gjasa të më thonte t'ia jepja atë fustan që ishte i ri, sesa atë që ishte i veshur disa herë.

Mbreti David thotë tek 2 Samueli 24:24, në lidhje me ndërtimin e tempullit: "Jo unë do t'i blej këto gjëra nga ti me çmimin që kushtojnë dhe nuk do t'i ofroj Zotit, Perëndisë tim, holokauste që nuk më kushtojnë asgjë." E shikoni, mishi ynë nuk e ka për gjë të heqë dorë nga diçka që do të thotë "asgjë" për ne. Megjithatë, një fustan i ri, i kuq, është tjetër histori. Për ta dhënë, mua më duhej të sakrifikoja.

Arsyeja ime e fundit ishte vërtet qesharake. Thashë: "Zot, po unë kam blerë edhe këto vathë të bukur në të kuqe dhe të argjendtë që të shkojnë me fustanin." Këtë

e thashë me zë shumë të zymtë dhe keqardhje. Mendoj se po shpresoja që Zotit t'i vinte keq për mua. Përgjigjja e tij ishte një heshtje e plotë ndaj dy arsyeve të mia të para dhe komentit tim të tretë në lidhje me vathët. Ai më bëri të kuptoj se unë mund t'i jepja asaj edhe vathët, nëse mbajtja e tyre pa fustanin do të ishte problem.

Perëndia nuk debaton me ne. Ai na tregon nëpërmjet *një dëshire, njohjeje, përshtypjeje në frymën tonë, nëpërmjet një qetësie, zëri të ulët dhe, me raste, me zë të lartë ose shpesh nëpërmjet Fjalës së Tij, që të na prekë*. Mos harroni, Perëndia nuk do t'ju udhëheqë të bëni diçka jashtë vullnetit të Tij, që është Fjala e Tij! Gjithashtu, kini kujdes nga udhëheqja me anë të zërave! Ka shumë zëra. Sigurohuni që fryma juaj mban dëshminë e Frymës së Shenjtë!

Fryma ime mbajti dëshminë e Ruth Ann për të pasur atë fustan, por mishi im nuk donte të dorëzohej. Kështu unë vazhdoja të ngrija *arsye* para Perëndisë se përse nuk kishte kuptim. Por Perëndia nuk debatoi me mua. Ai kishte thënë atë që kishte për të thënë. Nëse ju kujtohet se çfarë po ndodhte që në fillim, unë po mendoja për Ruth Ann dhe se çfarë bekimi kishte qenë dhe *e pyeta Perëndinë* se çfarë mund të bëja për të. Ai më tha, por koka ime (*arsyetimi*) nuk e pëlqeu, edhe pse fryma ime e dinte që ishte e drejtë. Tani më mbetej mua të *vendosja*.

Kështu vendosa që ta lija për momentin. Kjo është zakonisht mënyra jonë e preferuar për t'i bërë bisht asaj që Perëndia po na thotë të bëjmë, pa bërë shumë zhurmë për mosbindjen, ose të *paktën kështu mendojmë*. Aktualisht, zvarritja është mosbindje. Synimet e mira nuk janë bindje. Veprimi i bazuar mbi Fjalën e Perëndisë është bindje.

Kaluan disa javë dhe unë e harrova fare të gjithë këtë incident, *por Perëndia nuk e kishte harruar*. Po lutesha për Ruth Ann dhe faktikisht unë i thashë Atij të njëjtën gjë sërish. “Perëndi, si mund ta bekoj unë Ruth Ann?” Ja ku qëndronte sërish. I njëjti fustan i kuq më shfaqej përbrenda. Më në fund e kuptova se nuk po i bindesha dhe ia dhashë asaj fustanin e kuq.

Faktikisht kuptova, pasi vendosa që t’ia jepja asaj, se atë fustan unë e kisha blerë për të dhe kjo ishte arsyeja përse qëndronte i varur në dollapin tim për tre muaj, i ri dhe as që e kisha nxjerrë nga qesja. Zoti, sigurisht, i di të gjitha këto gjëra që më parë në kohë, por ne gjithsesi mund të bëjmë një projekt nga bindja. E gjithë kjo rrëmujë u krijua nga njeriu natyror që nuk kupton njeriun frymëror, për të cilin flet 1 Korintasve 2.

“Pse, o Zot, pse?” thotë njeriu natyror. “Përse do që unë të sakrifikoj? Përse nuk mund të jetë e lehtë? Përse

duhet të jetë kaq e vështirë? “Te Romakëve 8:6 thuhet se mendja e mishit është kuptim dhe arsye, por pa Frymën e Shenjtë. Gjithashtu na përcjell mendimin se kjo lloj sjelljeje vjedh paqen tonë.

Nëse keni humbur synimin tonë kryesor në këtë libër, më lejoni t’ju kujtoj se po përpiqem të them se arsyetimi “Pse, o Zot, pse?” është një nga gjërat që shkakton pështjellim, vjedh paqen tonë dhe së fundi, gëzimin tonë.

A dëshironi ta shijosh jetën? Atëherë “arsyetimet” duhet të largohen!

8



“ARSYETIMET” SHKAKTOJNË MASHTRIM

E vetmja shpresë për të mos u mashtruar këto ditë, është të mësojmë të ecim në Frymë, të udhëhiqemi nga Fryma dhe jo nga mishi. Satani po kërkon të krishterë të mishtë që udhëhiqen nga koka e tyre, ndjenjat dhe vullneti i tyre dhe jo nga Fjala dhe Fryma. Ne nuk mund të veprojmë, sepse ndihemi të tillë ose nuk ndihemi të tillë. Ne duhet të veprojmë të udhëhequr nga Fryma, për hir të Mbretërisë dhe për mbrojtjen tonë.

Mendja pëlqen të fshehë çdo gjë. Ajo dëshiron të gjejë ndonjë vend për të vendosur çdo gjë, në mënyrë që të duket se ka kuptim dhe se po tregohet kujdes. Ne nuk na pëlqejnë pyetjet pa përgjigje. Një nga mjetet që përdor Fryma për të kryqëzuar mishin tonë janë pyetjet pa përgjigje. Kur nuk *e dimë* përgjigjen, duhet ose t'i

besojmë Perëndisë, ose të shqetësohemi dhe të përpiqemi ta gjejmë vetë.

Puna e Frymës së Shenjtë është t'i sjellë besimtarët në një pikë pjekurie, pasi Jezusi i ka shpëtuar. Një besimtar që mund t'i besojë Atit kur gjërat duken se nuk kanë kuptim, ai është një besimtar i pjekur. Rrjedhimisht, Perëndia jo gjithmonë na i jep përgjigjet e të gjitha pyetjeve, pasi Ai po na stërvit në besim. Megjithatë, duhet të kujtoni se mendja juaj është në kundërshtim të plotë me gjithë këtë plan të Perëndisë. Mendja juaj është natyrore dhe konsiderohet si pjesë e mishit derisa të bëhet e re dhe të mësojë të *mendojë në mënyrë frymërore*.

Romakëve 8 flet për mendjen e mishit dhe mendjen e Frymës. Te Galatasve 5:17, thuhet se mishi është në kundërshtim me Frymën dhe Fryma është në kundërshtim me mishin dhe se ato vazhdimisht janë në konflikt me njëra-tjetrën.

Le t'i kthehemi mendimit tonë fillestar në fillim të këtij kapitulli. Mendja natyrore dëshiron të vendosë çdo gjë diku dhe ta mbyllë atë në një kosh të vogël ku futet mirë dhe nuk na lë të paditur.

Dikur kemi pasur një grup kutish postare në zyrën tonë. Secila prej kutive kishte emrin e një punonjësi sipër. Kur doja t'i dërgoja ndonjë udhëzim ose mesazh një

punonjësi të caktuar, vendosja një shënim mbi kutinë e atij punonjësi. Ndonjëherë, kur diçka që kisha kërkuar të bënte ndonjë punonjës, nuk ishte realizuar, atëherë pas kontrollit kuptoja se shënimin e kisha vendosur mbi kutinë e gabuar. Ngandonjëherë madje e kisha vendosur mbi kuti bosh që nuk kishte asnjë emër.

Zoti i përdori këto kuti për të më mësuar këtë mësim që po përpiqem t'ju mësoj juve. Ai më tregoi se ashtu siç i vendosja gjërat në kutitë e gabuara në zyrë, unë gjithashtu nganjëherë i vendos gjërat në kutitë e gabuara në kokën time. Unë gjithmonë dëshiroja të *vendosja* çdo gjë diku në mendimet e mia dhe kështu të kisha një pako të vogël, të pastër, me fund të hapur, e cila pluskonte përreth ku më duhej, që me të t'i besoja Perëndisë. Unë kisha një problem të madh me "arsyetimet". Shpesh pyesja: "Pse, o Zot, pse?" Prandaj kisha shumë pështjellim dhe shqetësim, si edhe një mungesë paqeje dhe gëzimi.

Nganjëherë mashtroja edhe veten-dhe Zoti ma tregoi këtë-sepse kishte raste që mendoja se e kisha kuptuar një çështje të caktuar dhe veproja, ose nuk veproja, sipas asaj që kisha menduar. Por më vonë, pasi kisha bërë gjithçka rrëmujë, do të shihja që edhe pse kisha menduar se e dija, apo se kisha kuptuar gjithçka, në të vërtetë e kisha futur në kutinë e gabuar.

Perëndia përdori Fjalët e Urta 3:7 për të ma sjellë këtë të vërtetë para syve: “Mos e mbaj veten të urtë në sytë e tu.” Zoti më tregoi se nuk isha e zgjuar as sa gjysma e asaj që mendoja se isha. Nuk e kam fjalën këtu për urtësi mendore. Po flas për opinionin tonë për vetveten - që i kuptojmë të gjitha gjërat.

Te Fjalët e Urta 3:5-6 thuhet:

“Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të të drejtojë shtigjet e tua.”

Kur Perëndia ju drejton, nuk keni asnjë pështjellim apo dyshim, por nëse përpiqeni të arsyetoni dhe kuptoni, atëherë mund të futeni në një rreth pa fund duke mos mundur të mësoni kurrë të vërtetën. Te vargu 7 thuhet: “Mos e mbaj veten të urtë në sytë e tu.”

Këtu kemi dy mënyra për ta trajtuar këtë situatë: një është e saktë dhe tjetra e pasaktë; një është frymërore dhe tjetra është e mishit. Le të themi se dikush më jep një profeci personale të cilën nuk e kuptoj, ose le të themi se pashë një ëndërr frymërore të cilën nuk e kuptoj. Unë mund të shkoj para Atit dhe t’i them: “At, unë nuk e kuptoj këtë. Kam dëshirë ta kuptoj dhe po të kërkoj Ty të ma japësh zbulesën. Më bëj ta kuptoj.”

Pastaj gjënë që nuk e kuptoj, e vendos në raft. Me fjalë të tjera, nuk e mbaj më mendjen tek ajo. Unë e lë atë në duart e Perëndisë. Nëse dhe kur Ai është gati të më bëjë ta kuptoj, Ai ka për ta marrë nga rafti dhe do të ma sjellë para syve që ta kujtoj. Te Gjoni 14:26 thuhet se Fryma e Shenjtë na kujton. Ai do të më bëjë që nëpërmjet zbulesës të *di* atë që kurrë nuk kam kuptuar.

Mënyra e dytë se si mund ta trajtoj këtë situatë, nëse do të shihja një ëndërr apo do të më thuhej një profeci të cilën nuk e kuptoja, do të ishte që vërtet të filloja të përpiqesha ta kuptoja. Do të flisja me sa më shumë njerëz për këtë gjë dhe do të merrja opinionin e tyre. Këtu mund të shtoj se shumica e tyre ndoshta do të kishin opinione të ndryshme dhe kështu kjo do t'i shtohej pështjellimit tim. Pastaj, kur të kuptoja diçka, atëherë do të nisja të veproja. Por në të vërtetë, nëse do të jem akoma e qetë dhe e singertë me veten, do më duhet të them se brenda meje nuk do të kisha paqe. Nëse do të vazhdoja të përpiqesha që të bëja diçka të ndodhte, bazuar në atë që "unë mendoja" në lidhje me këtë ëndërr, profeci apo vizion, *atëherë do të përfundoja duke shkaktuar një rrëmujë të madhe.*

Mos harroni, "arsyetimet" shkaktajnë pështjellim! Nuk po them se nuk duhet të mendojmë për çështje të

caktuara, por ka një dallim në meditimn e gjatë mbi diçka, për të parë nëse mund të kuptohet dhe përpjekjes së madhe për ta kuptuar, aq sa të sjellë një ngatërresë totale.

Kur të ndiheni të pështjelluar, merreni këtë si një sinjal paralajmërues se po trajtoni diçka në mënyrë të gabuar.

9



PËSHTJELLIMI VJEDH GËZIMIN TUAJ

Në këtë kapitull të fundit, më lejoni të ritheksoj se *pështjellimi nuk vjen nga Perëndia*. Te Letra e Parë drejtuar Korintasve 14:33, thuhet: “Sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi”. Te Kolosianëve 3:15, thuhet që ta lejojmë paqen të jetë “gjykatësi” që merr vendimin në jetët tona. Paqja, si një gjykatës, na tregon se çfarë është brenda dhe çfarë është jashtë.

Pështjellimi është ekzaktësisht antonimi i paqes. “Pështjellim” do të thotë gjithçka e përzier bashkë, e papastër, rrëmujë, për të ngatërruar një gjë me një tjetër apo për ta bërë më të mjegullt. “Paqe” do të thotë rregull, jo trazirë, kënaqësi e brendshme, qetësi. Nëse një person nuk ka paqe, ai ose ajo nuk do të ketë gëzim. Jezusi tha te Gjoni 10:10 se hajduti vjen për të vjedhur, vrarë dhe

shkatërruar, por Ai, Jezusi, erdhi që ne të mund “të kemi dhe shijojmë jetën.”

Unë vendosa para pak vitesh se do të shijoja Perëndinë dhe jetën. Nëse Jezusi vdiq për mua me qëllim që unë jo vetëm të kem jetën, por gjithashtu edhe ta shijoj atë, atëherë duhet të përpiqem ta shijoj atë.

Te Gjoni 15, lexojmë se si Jezusi shpjegoi ku mbështetet jeta, e cila i referohet hyrjes në prehjen e Perëndisë. Në vargjet 1-10, Ai flet për jetën se ku mbështetet. Pastaj te vargu 11, Ai thotë:

“Këto gjëra jua kam thënë që gëzimi im të qëndrojë në ju dhe gëzimi juaj të jetë i plotë”.

Sigurisht që tingëllon se Ai dëshiron që ne të shijojmë jetën. Pështjellimi patjetër do ta pengojë përmbushjen e këtij synimi.

Në përfundim, dëshiroj t’ju inkurajoj të merrni një vendim që të jetoni në gëzim dhe jo në pështjellim dhe trazira. Do t’ju duhet të hiqni dorë nga “arsyetimet”. Sa herë që arrijmë një fitore frymërore, na kërkohet të heqim dorë nga diçka e natyrës së mishit. Natyra e mishit është “të përpiqemi të kuptojmë gjërat.” Natyra e frymës është “t’i besojmë Perëndisë të na zbulojë përgjigjen në kohën e Tij”.

Nëse do të hiqni dorë nga “arsyetimet”, atëherë besoj me të vërtetë se do të korrni *paqe dhe gëzim*.

TË PËRJETOSH NJË JETË TË RE



Nëse nuk e keni ftuar kurrë Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin juaj, atëherë ju ftoj ta bëni këtë gjë tani. Ju mund të thoni këtë lutje dhe nëse do të jeni vërtet të sinqertë, do të përjetoni një jetë të re në Krishtin.

At Perëndi, unë besoj se Jezu Krishti është Biri Yt, Shpëtimtari i botës. Unë besoj se Ai vdiq në kryq për mua dhe mori të gjitha mëkatet e mia. Ai shkoi në ferr në vendin tim dhe triumfoi mbi vdekjen dhe varrin. Unë besoj se Jezusi u ringjall nga të vdekurit dhe tani qëndron i ulur në të djathtën tënde. Kam nevojë për Ty, Jezus. Fali mëkatet e mia, më shpëto, eja dhe jeto brenda meje. Unë dua të lind sërish.

Tani, besoni se Jezusi jeton në zemrën tuaj. Ju jeni falur dhe jeni shpallur të drejtë dhe kur Jezusi të vijë, ju do të shkoni në parajsë.

Gjeni një kishë të mirë që mëson Fjalën e Perëndisë dhe filloni të rriteni në Krishtin. Asgjë nuk do të ndryshojë në jetën tuaj nëse nuk e njihni Fjalën e Perëndisë.

Të dashur,

Gjoni 8:31-32 thotë: “Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë dishepujt e mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë të lirë.”

Ju nxis të qëndroni në Fjalën e Perëndisë, ta mbillni atë thellë në zemër dhe sipas 2 Korintasve 3:18, ndërsa shikoni drejt Fjalës, ju do të shndërroheni në shëmbëllimin e Jezu Krishtit.

Më shkruani dhe më thoni nëse e keni pranuar Jezusin dhe kërkon për një libër të vogël falas mbi fillimin e jetës së re në Krishtin.

Me dashuri,

Joyce

DY FJALË RRETH AUTORES

JOYCE MEYER është një nga mësueset kryesore praktike të Biblës në botë. Si autorja Nr.1 më e shitur e gazetës *New York Times* ajo ka shkruar më shumë se tetëdhjetë libra frymëzues, përfshirë këtu *Kurrë mos u dorëzo*, *Sekreti i kënaqësisë së vërtetë*, *100 mënyra për të thjeshtëzuar jetën tënde*, gjithë grupin e librave *Fushëbeteja e Mendjes*, si dhe nismën e saj në gjininë e romanit me titullin *Qindarka dhe Çdo Minutë*, dhe shumë të tjerë. Ajo gjithashtu ka transmetuar mijëra mësimet audio, dhe ka tashmë një bibliotekë të plotë në video. Programet radio-televizive të Joyce Meyer, *Të shijosh jetën e përditshme*[®] transmetohen në mbarë botën, ndërkohë që ajo udhëton shumë për të mbajtur konferenca. Mesazhet e saj, ju mund t'i ndiqni në disa gjuhë të ndryshme në **tv.joycemeyer.org**. Joyce dhe bashkëshorti i saj, Dave, janë prindërit e katër fëmijëve të rritur dhe banojnë në St. Louis, Missouri.

Shërbesa Joyce Meyer, Shqipëri
c/o AEP Box 50, KP 119
Tiranë
ose telefononi: 0692055966

*Ju lutemi, kur të shkruani, përfshini dëshminë tuaj ose ndihmën
që keni marrë prej këtij libri. Kërkesat tuaja të lutjes janë të mirëpritura.*

Në SHBA, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries
P.O.Box 655
Fenton, MO 63026
USA
(636) 349- 0303
www.joycemeyer.org

Në Kanada, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— Canada
Lambeth Box 1300
London, ON N6P 1T5
CANADA
1- 800- 727- 9673

Në Australi, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— Australia
Locked Bag 77
Mansfield Delivery Centre
Queensland 4122
AUSTRALIA
(07) 3349 1200

Në Angli, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— England
P.O. Box 1549
Windsor SL4 1GT
UNITED KINGDOM
01753 831102

Në Afrikën e Jugut, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— South Africa
P.O. Box 5
Cape Town 8000
SOUTH AFRICA
(27) 21- 701- 1056

LIBRA NGA JOYCE MEYER NË SHQIP

Fushëbeteja e Mendjes

Një Mënyrë e Re Jetese

Paqe

Kur, o Zot, Kur?

Revolucioni i Dashurisë

Thuaji Se i Dua